

Përshëndetje,

në vijim të shkresës tuaj Nr. 134/18 Prot, protokolluar në institucionin tonë me Nr. 1595 Prot, datë 30.05.2018, nëpërmjet së cilës kërkonti dokumentacion informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit me poshtë do gjeni informacionin përkatës:

1. Sa është numri I projekt-akteve që janë hartuar nga institucioni juaj për periudhën 01.01.2017-30.03.2018?

Numri i projekt-akteve të hartuara nga Bashkia Devoll është 104 për vitin 2017 dhe 28 për vitin 2018.

2. A I janë nënshtruar projekt-aktet e mësipërme procedurës së njoftimit dhe konsultimit public?

Cdo mbledhje këshilli në të cilat miratohen projekt-vendimet, paraprakisht axhenda bëhet e njohur në website e Bashkisë Devoll bashkiadevoll.al ku njoftohen të gjithë banoret e Bashkisë Devoll për të qënë pjesë e mbledhjes në bazë të interesit të tyre.

3. Sa është numri I seancave dëgjimore të zhvilluara? Na vendosni në dispozicion kopje të procesverbaleve të mbajtura gjatë seancave dëgjimore?

Numri i seancave dëgjimore të zhvilluara për vitin 2018 është 55 seanca dëgjimore.

4. Sa është numri I komenteve/rekomandimevetë dërguara nga grupet e interesit për projekt-aktet e mësipërme? Sa nga këto komente/rekomandime janë marrë parasysh në draftin përfundimtar? Nuk ka pasur komente/rekomandime nga grupet e interesit deri tani, duke qënë se tashmë vendimmarrja me pjesëmarrje e ka bërë më të lehtë komunikimin dhe diskutimin ndërmjet organeve të qeverisjes vendore dhe qytetarëve.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!